



01 Nr. 370/26 Dt. 10.08.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Marrëveshjes për Mirëkuptim për Bashkëfinancim të Projektit 01. Nr. 237/26, të datës 02.06.2026, të nënshkruar mes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Komunës së Prizrenit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e realizimit të projektit: “Ndërtimi i parkut urban në lagjen Dardania në Prizren”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Komunës së Prizrenit-54615.
3. Ky projekt realizohet konform Marrëveshjes për Mirëkuptim për Bashkëfinancim të Projektit 01. Nr. 237/26, të datës 02.06.2026, të nënshkruar mes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - MZHR,
 - Arkivës së Kryetarit.